Bisedë zhvillimore

Si i ka punët në shkollë fëmiu juaj?

Bisedë zhvillimore

Njëherë në gjysmëvjetor ju dhe fëmiu juaj takoheni me mësuesin apo kujdestarin e klasës për një bisedë zhvillimore. Biseda do të bëjë fjalë për ecuritë zhvillimore të fëmiut tuaj në shkollë, si qëndron fëmiu në lëndët e ndryshme mësimore dhe si të vazhdohet më tutje.

Mbi çka do të bisedohet

Në bisedën zhvillimore do të bisedohet mbi të arriturat e fëmiut tuaj prej bisedës së fundit zhvillimore, çka e kishte më lehtë të mësojë dhe cilat janë vështirësitë. Ju dhe mësuesi apo kujdestari i klasës do të diskutoni mbi atë se çka do të mund të bëhej që fëmiu juaj të mësojë edhe më shumë. Gjatë kësaj bisede ju poashtu do të bisedoni edhe mbi atë se si sillet fëmiu juaj me fëmijët tjerë dhe ndaj personelit të shkollës. Ndoshta ekzistojnë situata për të cilat fëmiu juaj ka nevojë për ndihmë për t'u dalë në krye apo situata të cilat fëmiu e ka vështirë t'i kuptojë.

Së bashku me fëmiun ju mund të shprehni mendimet tuaja mbi atë se si funksionon shkolla. Nëse ju mendoni se diçka do të duhej të ndryshohet është mirë që këtë t'ia kumtoni mësuesit. Me këtë rast ju keni poashtu mundësi të diskutoni mbi atë se çka ka nevojë më shumë fëmiu juaj dhe si ju si prind mund t'i ofroni mbështejtje fëmiut tuaj.

Vlerësim me shkrim

Pas bisedës zhvillimore fëmiut tuaj do t'i dorëzohet një vlerësim me shkrim. Ky vlerësim nuk është dëftesë notash me të cilën ju do të mund të krahasoni të arriturat e fëmiut tuaj me bashkëmoshatarë tjerë të tij, në këtë vlerësim vetëm ceken të arriturat e fëmiut tuaj në lëndë të ndryshme mësimore. Në vlerësimin me shkrim ju mund të shihni nëse fëmiu juaj ka mësuar atë që ishte menduar dhe planifikuar të mësojë. Në rast se fëmiu juaj ka vështirësi në mësime atëherë kjo përbën një arsye të fortë që duhet të ceket në vlerësimin me shkrim dhe me anë të kësaj të kërkohet ndihmë plotësuese për fëmiun tuaj.

Disa shkolla praktikojnë që në vlerësimin me shkrim të cekin edhe të arriturat e nxënësit në çështje tjera si p. sh. në zhvillimin social të fëmiut. Vlerësime të këtilla bëhen që "të mbahet përgjegjësi më e madhe në studime" dhe "që fëmiu të kuptojë situatën e njerëzve tjerë".

Plani individual zhvillimor

Pas bisedës zhvillimore mësuesi sajon një plan individual zhvillimor për fëmiun tuaj, në bazë të asaj që keni arritur gjatë bisedës. Ky plan duhet të përmbajë masa konkrete të cilave shkolla dhe mësuesi duhet t'u përmbahen që fëmiu juaj të mësojë më shumë në të gjitha lëndët mësimore. Plani mund të përmbajë edhe propozime të ndryshme mbi kontributin tuaj në zhvillimin e fëmiut. Një ekzemplar të planit zhvillimor mbani edhe ju edhe fëmiu juaj. Kontrollojeni shkresën nëse ka mbetur diçka me rëndësi që nuk është cekur në të.

Disa fakte mbi atë që mban përgjegjësinë mbi bisedën zhvillimore dhe vlerësimin me shkrim

Drejtori i shkollës mban përgjegjësinë që të gjithë mësuesit të mbajnë bisedë zhvillimore me nxënësit e tyre dhe që prindërit të informohen mbi zhvillimin dhe situatën shkollore të fëmiut të tyre. Përveç kësaj drejtori i shkollës mban përgjegjësinë edhe mbi formën e vlerësimeve me shkrim dhe mbi atë nëse është e domosdoshme që në këto vlerësime të ceken edhe aspekte tjera të zhvillimit të fëmiut tuaj. Drejtori vendos kur shkolla të ketë nevojë që të shqyrtojë ndihmë plotësuese për nxënës me nevoja të veçanta dhe që shkolla të përpilojë programin mbi masat që duhet të zbatohen. Është drejtori ai që mban përgjegjësinë që këto masa të realizohen.

Mësuesi mban përgjegjësinë që të mbajë bisedë zhvillimore dhe të përpilojë planin zhvillimor. Mësuesi duhet që çdo nxënësi t'i japë një vlerësim me shkrim dhe që në vlerësim të figurojnë qartë të arriturat e nxënësit në zhvillim të njohurive.

Prindët mbajnë përgjegjësi që të bashkëpunojnë dhe që të parashtrojnë pyetjet dhe pikëvështrimet e tyre në bisedë zhvillimore.

Fakte mbi programin e masave

Kur një nxënës të ketë nevojë për ndihmë plotësuese shkolla është e detyruar që të mësojë mbi nevojat konkrete të atij nxënësi dhe në bazë të këtyre nevojave të përpilojë një të ashtuquajtur program masash. Në këtë program duhet të ceket për çfarë lloj ndihme nxënësi ka nevojë dhe si mundet shkolla ta përpilojë dhe zbatojë këtë mbështetje. Që e gjithë kjo të realizohet si edhe është paramenduar duhet që në këtë program të ceken ata që mbajnë përgjegjësinë mbi zbatimin e programit dhe mënyrën se si është menduar që të realizohet programi. Ju si prind keni të drejtë të merrni pjesë në zbatimin e programit dhe të ndikoni në të.

Fakte mbi mbajtje sekreti

Vlerësimi me shkrim dhe plani zhvillimor janë dokumente publike. Kjo do me thënë se këto dokumente mund t'i ipen çdokujt që i kërkon ato. Prandaj dhe është me rëndësi që këto dokumente të mos përmbajnë të dhëna delikate për nxënësin. Nëse në këto shkresa megjithëkëtë ekzistojnë të dhëna delikate që kanë të bëjnë me ligjin për mbajtje sekreti atëherë është mirë që këto të dhëna të fshihen para se dokumenti të dorëzohet.

Në ligjin për mbajtje sekreti ceket se cilat janë ato të dhëna që përfshihen nga ky ligj. Shkolla të pavarura dhe private nuk i nënshtrohen të ashtuquajturit princip publik prandaj dhe nuk janë të detyruara t'i dorëzojnë ndokujt dokumente.

Lexoni më shumë:
Allmänna råd och kommentarer. Den individuella utvecklingsplanen med skriftliga omdömen
www.skolverket.se/iup

Skolverket

www.skolverket.se

Fyklunds 2009